

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil, Gjyqtarja Mevlide Shabani, kryetare e trupit gjykues dhe Mahbub Haziri dhe Tefik Muji ,anëtarë të trupit gjykues me bashkëpunëtoren professionale Vlora Selmani – Rahimi, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditëses L. S.u nga fshati V. të cilën sipas autorizimit të dhënë nga Zyra Rajonale për Ndihmë Juridike Falas në Gjilan, e përfaqëson av. R.S, nga Gjilani, kundër të paditurëve Xh.S, M. L dhe R. L. të përfaqësuar nga H. L nga Gjilani, për vërtetimin e atësisë dhe amësisë, në seancën jopublike të datës 05.12.2016 , mori këtë :

A K T G J Y K I M

APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses L. S. nga fshati V. K. e Gj. e ushtruar ndaj të paditurve Xh. S, M. L. dhe R. L. nga Gjilani dhe **VËRTETOHET** se paditësja L. S e lindurnë Gjilan , është fëmiju biologjik i nënës M. L e lindur S, e lindur me date....., në Gjilan dhe nga babai R. L, i lindur më datënë fshatin K, e lindur nga bashkësia jashtëmartesore e prindërve biologjik të saj, ndërsa martesën e tyre kanë zyrtarizuar në Zyrën e Gjendjes Civile në Gjilan me datë.....,me numër M.....

II. Obligohet Zyra e Gjendjes Civile në Gjilan, që të bëjë ndryshimin në bazë të këtij aktgjykimi

III. Shpenzimet e procedurës i bartë secila palë veç e veç.

A r s y e t i m

1.Rriedha e çështjes

Paditësja L. S. nga fshati V. K, në këtë gjykatë ka ushtruar padi për vërtetimin e atësisë dhe amësisë kundër të paditurve; Xh. S, M.L dhe R. L.dhe ka kërkuar që të vërtetohet se ajo është fëmiju biologjik e lindur nga bashkësia jashtëmartesore e nënës së saj M. L dhe R. L .

2.Jurisdiksioni dhe kompetenca e gjykatës

Fillimisht, gjykata shqyrtoi jurisdiksionin e kësaj çështje dhe bazuar në nenin 45 të LPK lidhur me nenin 29, për kompetencën lëndore, konstaton se kjo gjykatë është e kompetencës lëndore dhe territoriale për zgjidhjen e kontestit.

3.Pretendimet e palëve ndërgjyqjësë

Paditësja L. S nga fshati V, përmes përfaqësuesit të saj me autorizim av R.S, pretendon se nuk është kontestues fakti se paditësja është fëmiju biologjik e lindur nga tani e paditura e dytë M. L e lindur S. dhe nga babai R. L, nga bashkësia jashtëmartesore, ndërsa vetëm formalisht është regjistruar në emër të tezes së saj tani të paditurës së parë Xh. J e lindur S , për shkak se nëna e paditëses e paditura M. L nuk kishte sigurim shëndetësor – librezë të shëndetësisë dhe në këtë lindje të paditëses L. S, e ka përodrur librezën shëndetësore të motrës së saj tani të paditurës së

parë Xh. S e të cilin fakt nuk e kontestojnë as të paditurit ,e as vet paditësja pasi që e njëjta jeton me prindërit e saj biologjik përkatësisht me të paditurën e dytë M. L dhe babain R. L duke kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia e paditëses në tërësi si e bazuar dhe vërtetohet se paditësja është vajzë e prindërve biologjik tani të paditurve M. dhe R. L .

E autorizuar e të paditurëve M. L. dhe R. L. ,- vajza e tyre H.L. ka deklaruar se është konsultuar me prindërit e saj në gjuhen e tyre pasi që të njëjtit janë janë shurdhmemec dhe nuk mund të komunikojnë me gjykatën por ka e ka sqaruar rastin e lindjes së motrës së saj tani paditëses H.L, se për lindjen e saj është përdorur librezja e shëndetësisë së tezes saj tani të paditurës Xh.S , meqenëse prindërit e saj tani të paditurit M. dhe R. L në atë kohë kur kishte lindur L. nuk kishin librezë shëndetësore për lindjen e saj dhe e kanë përdorur librezën e tezes se saj , dhe ka kërkuar që kërkesëpadia e paditëses në tërësi të aprovohet si e bazuar .

E paditura Xh. S. ka deklaruar se nuk e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditëses Xh. S, duke shtuar se nuk është nënë biologjike e tani paditëses , por prindër biologjik të saj janë të paditurit M. dhe R. L nga fshati V., dhe se e njëjta është tezja e saj , mirëpo për shkak se motra e saj tani e paditura M.e kishte përdorur librezën shendetsore të saj për lindjen e tani paditëses L , mirëpo në çertifikatën e lindjes së paditëses e njëjta figuron si nënë e saj ashtu që kërkoj nga gjykata që të bëhen ndryshimet në çertifikatën e lindjes së paditëses dhe njëjta të regjistrohet se prindër biologjik të saj janë të paditurit M dhe R .Ldhe në fund ka kërkuar që kërkesëpadia e paditëses të aprovohet në tërësi si e bazuar .

4.Provat e administruara në shqyrtimin kryesor

Leximi i librezës për realizuesit e së drejtës në pension e personave me aftësi të kufizuara të lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale Departamenti i Adminisnitratës Pensionale , leximi i ekstraktit nga regjistri i gjendjes civile nr. E ... i datës ...në emër te L. leximi i çertifikatës së martesës me numëre datës...., në emër të Rizat Lakna dhe Mevlide Lakna e lindur Sejdiu .

5.Vlerësimet juridike dhe faktike të gjykatës

Pas analizimit të thënjeve të palëve ndërgjyqëse, deklaratave të tyre, provave të administruara gjykata konstatoi se paditësja L. Lishte regjistruar në mënyrë të gabuar në emër të tezes së saj tani të paditurës Xh. S, për shkak se nëna biologjike e saj gjatë kohës së lindjes në Spitalin në, ka shfrytëzuar Librezën Shëndetësore të motrës së saj tani të paditurës Xh. S për ti ikur pagesës së taksave dhe participimit në spital.

Ky fakt vërtetohet edhe nga deklaratat e paditëses , të paditurve e të cilët në deklaratat e tyre kanë pranuar se paditëja L. Sështë regjistruar me libeze shendetsore të tezes së saj Xh. S nga Gjilani, ndërsa ne te veretet eshte femije biologjik i të paditurve M. dhe R. L .

Poashtu gjykata ka vërtetuar se të paditurit M. L e lindur S. dhe R. L. janë hyrë në bashkësi jashtëmartesore para shume vitesh , por se këtë bashkësi jashtëmartesore e kanë zyrtarizuar duke lidhur kurorë më dt..... tek Sherbimi i Gjendjes Civile në

Ky fakt konfirmohet nga Ekstrakti i Librave Amë të të Kurorëzuarvetë dt. Të datës.....

Nga të cekurat më lartë gjykata e aprovoi kërkesën e paditësit si të bazuar me ligj dhe vendosi si në dispozitiv të vendimit duke u bazuar në nenin 99, 101 dhe 102, të Ligjit për familje i Kosoves,

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marr në pajtim me nenin 452 paragrafi 4 të LPK-së

Nga të cekurat më lartë, e bazuar në nenin 99, 101 dhe 102 të LMF-së, dhe nenit 143 par.1 të LPK-ës u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

**Gjyqtarja
Mevlide Shabani**

Këshilla juridike : Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë , Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh, pas ditës së pranimit të vendimit, përmes kësaj gjykate .